



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 12.05.2023

Nr: 107

Ora: 14:25

VENDIM

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS NR. 29, DATË 12.05.2023 TË KOMISIONERIT
SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 12.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKT: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj z. Fran Tuci kryetar i bashkisë Fushë Arrëz; z. Andis Salla, kryetar i bashkisë Cërrrik; z. Safet Gjici, kryetar i bashkisë Kukës; zj. Majlinda Qilimi, kryetar i bashkisë Delvinë; z. Adem Lala, kryetar i bashkisë Has; zj. Luiza Mandi, kryetar i bashkisë Libohovë; z. Elton Arbana, kryetar i bashkisë Shijak; z. Dritan Leli, kryetar i bashkisë Vlorë; z. Kreshnik Hajdari, kryetar i bashkisë Kuçovë; z. Bardh Spahia, kryetar i bashkisë Shkodër; z. Mark Babani,



kryetar i bashkisë Vau Dejës; z. Eduard Duro, kryetar i bashkisë Devoll;
z. Fredi Kokoneshi, kryetar i bashkisë Bashkia Divjakë.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja “dh”, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën për vënie sanksioni ndaj 13 (trembëdhjetë) kryetarë bashkie, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 29 regj., datë 12.05.2023. Në mbledhjen e datës 12.05.2023, ora 14:25, pas relativitetit të z. Ilirjan Rusmali, u konstatua se kërkesa i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 35, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe në mbështetje të nenit 45, pika 1, shkronja “c”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 29, datë 12.05.2023 të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 15.05.2023, ora 13:00.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

Ilirjan	RUSMALI	- Relator
Elvin	LAKO	- Anëtar
Elvis	ÇEFA	- Anëtar
Koli	BELE	- Anëtar
Ledio	BRAHO	- Anëtar